



Dalës-Izazna  
Nr. T-15  
Br.

Data 20.02.2018  
Datum



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47 dhe 48.3 te Statutit të Komunës si dhe nenit 3.9 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI, mbledhja e IV) me dt.28.02.2018 (e mërkurë) në ora 10:00, në sallën e re te Kuvendit komunal me këtë:

## RENDEZ DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Rishikimi i vendimeve të Kuvendit komunal të dt.24.01.2018 , me kërkesë të MAPL-së
  - a) Rishikimi i vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa -( KPF)
  - b) Rishikimi i vendimit për formimin e Komitetit për komunitete-
  - c) Rishikimi i vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi- ( KKSBB )
4. Shqyrtimi i kërkesës për iniciimin e procedurës për ndryshim – plotësimin e Rregullores komunale për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba
5. Ndarja e parcelës për Qendrën e Mjekësisë Familjare në Milloshevë
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë për periudhën shkurt 2018 deri në dhjetor 2019
7. Bartja e mjeteve buxhetore nga viti 2017 në vitin 2018
8. Formimi i Komisionit për dhënjen e pronës komunale në shfrytëzim
9. Shqyrtimi i kërkesës të Federatës së Futbollit të Kosovës
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim \* Gërguri



Dalës-Izlezna

Nr: 1-04

Data 24.01.2018

Br. Patim

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

OBILIC-OGLIC

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.24.01.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta këshilltarë: Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Florije Jashari, Agon Mjekiqi, Qëndresa Dubova, Shaip Paloja, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bekteshi, Linda Sadiku, Arbnore Nasufi, Hysni Mjeku, Lulzim Sadiku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Jakovljevic

Të pranishmit tjerrë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ajet Berisha, Nënkyetar i Komunës, Naim Miftari, drejtëor i DSHPE-së, Fitore Hashani, drejtoreshë e DKRS-së, Ibush Mjekiqi, drejtëor i DSHMS-së, Arben Berisha, drejtëor i DMM-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH, Slavisa Adjancic, shef i ZLKK-së, Drita Hashani, zyrtare ligjore, përf. e OSBE-së, përf. e UNMIK-ut etj.

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

## REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Formimi i Komiteteve obligative:
  - a) Komiteti për Politikë dhe Financa
  - b) Komiteti për komunitete
4. Formimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
5. Propozimi i Kryetarit të Komunës për zgjedhjen e Nënkyetarit për komunitete
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

**Burim Gërguri** – fillimisht para se ta aprovojmë rendin e ditës, ftoj z.Labinot Mirena dhe z.Armend Rushitin, që të jepin betimin solemn për këshilltarë të Kuvendit komunal.

Këshilltarët e përmendor më lartë dhanë betimin solemn para asambleistëve tjerë të Kuvendit komunal.

**Burim Gërguri** - i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

**Aziz Bici** – kërkoj sqarim rrëth pikës së pestë të rendit të ditës lidhur me propozimin e Kryetarit të Komunës për zgjedhjen e Nënkyetarit për komunitete.

**Burim Gërguri** – sqaron se njëherë e kemi aprovimin e rendit të ditës, pastaj kur vijmë në pikën e pestë do të flasim për këtë çështje.

**Aziz Bici** – kërkoj që vërejtja ime të pranohet.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës me vërejtjen e cekur më lartë.

**I.Pika e parë e rendit të ditës – u sqarua**

**II.Pika e dytë e rendit të ditës –**

Aprovohen njëzërit ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.

**III.Pika e tretë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – ju e keni para vetes Rregulloren e punës së Kuvendit dhe tash kemi aprovimin e shefave të grupeve parlamentare, kështu që fillojmë me propozime.

**Agon Mjekiqi** – propozon z.Enver Gashi, shef të grupit parlamentar të AAK-së.

**Fatos Kurshumlija** – propozon z.Shaip Paloja, shef të grupit parlamentar të LDK-së.

**Hysni Mjeku** – propozon z.Lulzim Sadiku, shef të grupit parlamentar të PDK-së.

**Nora Preniqi** – propozoj z.Armend Rushiti, shef i grupit të LB-së dhe Nisma.

**Lulzim Sadiku** – pyes se grupi parlamentar LB dhe Nisma, në çfarë forme dhe a kanë të drejtë të propozojnë në këtë formë.

**Burim Gërguri** – sipas Rregullores së punës së Kuvendit grupet ose individë të caktuar mund të lidhen në një grup dhe përfaqësimi i tyre shkon në emër të një grapi, kështu që LB dhe Nisma tani e kanë një përfaqësues si shef i grupit parlamentar.

**Xhezide Dragusha** - propozon z.Aziz Bici, si përfaqësues i grupit parlamentar të LVV-së.

**Burim Gërguri** – poashtu i kemi edhe 2 parti sérbe, që e kanë nga një përfaqësues dhe siç shihet kemi 4 grupe parlamentare dhe 3 përfaqësime politike ne Kuvendin komunal. Unë ju përgëzoj, dhe uroj që tash e tutje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe me shefat e këshilltarëve do të jemi në koordinim gjatë këtij mandati 4 vjeçar.

Tani kemi formimin e Komiteteve obligative: Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për komunitete.

a) Kryesuesi lexon nenin 5,6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.3/2014, që kanë të bëjnë me KPF-në, lidhur me përbërjen dhe kompetencat e tyre. Ne nuk duhet të harrojmë edhe një gjë se edhe pjesëmarrja e gjinisë femërore në KPF është e rregulluar me ligj. Ne e kemi edhe një kërkesë nga zyra për barazi gjinore, që në Komitete të jetë i përcaktuar numri dhe kuota e gjinisë femërore.

**Hysni Mjeku** – ne duhet të dijmë përbërjen e KPF-së.

**Burim Gërguri** - propozoj që KPF të jetë prej 7 anëtarëve, nga AAK të janë 2 anëtarë, LDK, 1 anëtarë, PDK 1 anëtarë, LB bashkë me grupin Nisma të kenë 1 anëtarë dhe 1 anëtarë nga komunitetet

**Shaip Paloja** – ju e lexuat Udhëzimin Administrativ, por duhet të bazoheni pak edhe në ligj sepse Udhëzimi del dhe bazohet në ligj. Ligji thotë se përfaqësimi i të gjitha komitetet duhet të jetë në formën reciproke aq sa është përfaqësimi ose fuqia politike e subjekteve. Në rastin konkret mendoj se AAK-ja dhe LDK-ja, bashkë e përbëjnë mbi 50 % të Kuvendit komunal, kështu që AAK-ja dhe LDK-ja duhet të kenë nga 2 anëtarë në KPF duke u bazuar se AAK-ja, e ka edhe kryesuesin për të cilin e dijmë të gjithë se ai në rastin e caktuar mund ta përdorë votën e dyfishtë. Konsideroj se në këtë rast fokusimi juaj kryesues lind si diskriminim ndaj LDK-së, dhe numri që duhet të përfaqësohet në KPF duhe të jetë nga AAK, 2 anëtarë, nga LDK 2, PDK 1 anëtarë, LB 1, dhe 1 anëtarë nga LVV-ja. Sa i përket komitetet, ne e dijmë se komitetet do të përfaqësohen mjaftueshmë nga Nënkyetari për komunitete. Është pak e tepërt dhe jo logjike LDK-ja, me kaq anëtarë që ka, e dikush me një anëtarë në çështje që po dua unë, por është përfaqësim politik, është votë e qytetarëve që ne e kemi obligim ti respektojmë ato vota të anëtarëve të Kuvendit, në këtë rast të LDK-së.

**Lulzim Sadiku** – propozoj në emër të grupit parlamentar të PDK-së, që AAK-ja, ti ketë 2 anëtarë, PDK 2, LDK 1 anëtarë, LVV 1 dhe LB 1 anëtarë dmth KPF-ja, me këtë përbërje ti ketë 7 anëtarë.

**Aziz Bici** – ne jemi për propozimin paraprak që e kemi dhënë të njejtë.

**Burim Gërguri** – kryesuesi i Kuvendit në këtë rast shkon ex officio dhe kështu e ka përcaktue ligji, e jo që kam dashtë unë. Poashtu, edhe pa një përfaqësim të komitetit në KPF, është diskriminim që kjo nuk ka ndodhë në asnjë mandat.

**Shaip Paloja** – kryesues të kisha lutë pak se kur është fjala diskriminim duhet të keni pak kujdes sepse këtu nuk po bëhet asnjë diskriminim, por po bëhet fjalë për një fuqi politike në Kuvend. Pra, nuk jemi duke e diskriminuar askend, përkundrazi mendoj se ata janë të privilegjuar se do ta kenë një Nënkyetar për komitetet dhe ky nuk është problem që ne duhet me trajtue. Nëse, dikush diskriminohet apo shkëlet atëherë jemi ne me propozimin që e dhatë ju më heret. Propozimi im dhe i kolegëve tjerë është shumë real sepse ligji thotë se përfaqësimi nëpër Komitete duhet të jetë proporcional me fuqinë politike që e kanë në Kuvend, që në këtë rast fuqia politike e AAK-së, PDK-së dhe LDK-së, është ajo që është dhe përfaqësimi duhet të jetë reciprok.

**Burim Gërguri** – tash i kemi 3 propozime, një që doli nga këshilltarët e grupeve të AAK-së, LB-së dhe të tjerëve, propozimin e LDK-së, e mbështeti PDK-ja, dhe LVV. Tani, propozimin e parë për formimin e KPF-së, e hedhim në votim, kryesuesi shkon ex oficio, AAK-ja ti ketë 2 anë tarë , LDK 1, PDK 1 anëtarë, LB 1, dhe SLS 1 anëtarë.

**Lulzim Sadiku** – vërtetë, po bëhet shkelje shumë e madhe ndaj LVV-së, në këtë rast të mos ketë përfaqësues sepse ne e dijmë se në Komunën e Obiliqit, LVV në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës është partia e dytë, kështu që është e vërtetë me numrin që ka të mbetet jashtë KPF-së, nuk është e drejtë.

**Burim Gërguri** – unë nuk jam duke e lënë jashtë KPF-së, por është Udhëzimi administrativ që e përcakton këtë çështje. Ne e kemi edhe Komitetin tjetër obligativ për komunitete, që besoj se propozimet konkrete do të kalojnë. Unë fillimisht ju thashë se në bazë të Rregullores obligohemi ti përcaktojmë se kush janë grupet parlamentare dhe kush janë përfaqësuesit të zgjedhur në Kuvendin komunal.

**Lulzim Sadiku** – te grupet parlamentare, vërtetë e pashë se u bë një e padrejtë te LVV-ja, dhe unë nuk di anëtarë i Kuvendit të Nismës që ka dhënë dorëheqje, kështu që kërkoj nëse ai në fakt kalon në LB duhet dëgjuar se ka dhënë dorëheqje nga Nisma dhe të kalon andej. Mirëpo, ne nuk e kemi as në procesverbal dhe nuk kemi

**Shaip Paloja** – prapë po them se po bëhet shumë një padrejtësi ndaj LDK-së dhe unë s'po e kuptoj kryesues ose ma shpjegon mua qysh mundet LDK-ja, me 5 anëtarë me pasë 1 anëtarë në KPF, e dikush tjetër me 1 anëtarë me pasë anëtarin në Komitet, që nuk ka kurrfarë logjike. Te grupi LB-Nisma, është e padrejtë sepse nëse LB-ja, me 2 anëtarë e ka një anëtarë në Komitet atëherë edhe LVV-ja, duhet ta ketë. Këta, mund të bëjnë grup, por nuk i takon këtij subjekti të LB-së, dhe Nismës sepse është e padrejtë. Të lutem sqaroje këtë çështje, me çfarë të drejte ti po na lejon neve të mbetemi me një anëtar në KPF, e dikush me një anëtar të vetëm bëhet anëtar i KPF-së, kur ligji thotë se zgjedhja e Komiteteve bëhet në formën reciproke të përfaqësimit politik në Kuvend.

**Aziz Bici** – lëvizja e tha se duhet të ketë përfaqësim sa më të madh në këtë Komitet dhe unë i ftoj të gjithë këshilltarët e Kuvendit komunal, pa dallim se përveç që ju takojnë grupeve të partive politike, mbane në mend se keni edhe votën e qytetarëve, ndoshta që ti leni anash interesat sepse LVV-ja, është e dëshmuar se ka koncept, është e dëshmuar për barazi dhe drejtësi. Ju ftoj sinqerisht që këtë ta keni e jo të kualicionit dhe kjo nuk do të shkon në interesin e qytetarëve.

**Burim Gërguri** - pikërisht për këtë arsy e ua solla Rregulloren e punës së Kuvendit dhe tani shkojmë me propozime për formimin e KPF-së.

**Enver Gashi** – nga AAK-ja, për anëtarë në KPF janë z. Enver Gashi dhe znj. Qëndresa Dubova.

**Lulzim Sadiku** – propozon z. Hysni Mjeku, anëtar në KPF.

**Nora Preniqi** – propozon z. Armend Rushiti nga LB dhe Nisma.

Para votimit të KPF-së, grupi parlamentar i LDK-së, e lëshoi mbledhjen.

**Dragan Dancecovic** – propozon z. Slavisa Jakovljevic nga SLS.

Pas diskutimeve, këshilltarët me 13 vota “Për” 2 vota “Kundër” dhe 1 votë “Abstenim” morën këtë :

## V E N D I M

**Formohet Komiteti për Politikë dhe Financa në përbërje prej 7 anëtarëve dhe atë :**

1. Burim Gërguri,
2. Enver Gashi, (AAK)
3. Qendresa Dubova, (AAK)
4. Gjinia femërore (LDK)
5. Hysni Mjeku, (PDK)
6. Armend Rushiti, (LB)
7. - (SLS)

Pas votimit të KPF-së, grupi parlamentar i LDK-së u kthye në mbledhje.

b) Komiteti për Komunitete

**Burim Gërguri** –në Komitetin për komunitete, do të jenë 9 anëtarë siç ka qenë edhe në mandatin e kaluar dhe tani shkojmë menjëherë me propozime.

**Enver Gashi** – në këtë Komitet 4 anëtarë janë prej Kuvendit komunal, ndërsa 5 do të zgjedhen me konkurs dhe me këtë rast propozoj që AAK-ja, të ketë 1 anëtarë, LDK 1, PDK 1, dhe LB bashkë me Nismën të kenë 1 anëtarë.

**Lulzim Sadiku** – propozoj që AAK-ja, të ketë 1 anëtarë, LDK-ja 1 anëtarë, PDK-ja 1, dhe LVV-ja, të ketë një anëtarë në Komitetin për komunitete.

**Aziz Bici** – edhe një herë ju ftoj të shihni se në çfarë situate na kanë sjellë partitë politike, kjo s'don koment sepse bëhen kontrata e marrëveshje me kompani të ndryshme për të cilat nuk ka transparencë. Ju po e shihni se çfarë skandale janë duke u bërë dhe mbane në mend se këto vendime që janë duke i marrë partitë e juaja në kualicion me qeveritarë, neve do të na kushtojnë shumë. Ju, qysh ja keni nisë kështu lëre më që s'keni me i përfaqësue interesat e qytetarëve, por më vonë keni me pa edhe ju vetë.

**Burim Gërguri** – të lutem z.Aziz, përmbaju rendit të ditës.

**Aziz Bici** – jo, unë jam brenda rendit të ditës, dhe ligji kërkon përfaqësim e ti më heret the diskriminim që më nuk e quan diskriminim, por e quan se je brenda Statutit dhe Rregullores. Mendoj se nuk keni të drejtë dhe më vonë do ta shihni, por do të bëhet vonë, prandaj le të jetë përfaqësimi ashtu qysh e kërkon ligji.

**Burim Gërguri** – të nderuar asambleistë, ju lutem kur të debatojmë, të debatojmë brenda rendit të ditës sepse kur kemi me shtue diçka, apo me debatue e kemi pikën e fundit të rendit të ditës “Të ndryshme”.

**Enver Gashi** – propozon z.Agon Mjekiqi, anëtar të Komitetit për komunitete.

**Shaip Paloja** – kryesues nëse, na lejohet ne emrat do ti sjellim më vonë.

**Burim Gërguri** – ju lutem z.Shaip, për shkak të vendimit duhet ti sjellni emrat sepse e kemi afatin ligjor për dërgimin e vendimeve në MAPL.

**Shaip Paloja** - ne më heret dolëm nga mbledhja sepse nuk jemi të kënaqur pwr arsyetë përfaqësimit, jemi të diskriminuar dhe jemi të shkelur

**Samire Berisha** – propozon z.Lulzim Sadiku, për anëtarë nga PDK-ja.

**Armend Rushiti** – propozon z.Nazmi Gashi, për anëtar në Komitetin për komunitete.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe asnjë votë “Abstenim” morën këtë :

## V E N D I M

**Formohet Komiteti për Komunitete me këtë përbërje:**

- 1.Agon Mjekiqi, (AAK)
- 2.Lulzim Sadiku, (PDK)
- 3.Nazmi Gashi, (NISMA dhe LB)

### **IV. Pika e katërt e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – tani e kemi formimin e KKSB-së, sipas Udhëzimit Administrativ nr.27/2012, MPB-03/2012 (MAPL).

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me 18 vota “Për” asnjë votë “Kundër” dhe 3 këshilltarë nuk marrin pjesë në votim, morën këtë :

## V E N D I M

**Formohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Obiliqit.**

### **V.Pika e pestë e rendit të ditës –**

**Kryetari** – ne edhe në të kaluarën e kemi pasë Nënkyetarin për komunitete sepse Komuna jonë është multietnike. Përveç kësaj ne e dijmë se edhe në qeverisjen nationale ka Ministri të ndryshme, që janë ministra nga komuniteti sërbë, që konsideroj se këta në vazhdimësi e jepin kontributin e tyre. Ne e shohim si të domosdodshme që të jetë një vazhdimësi meqë Komuna jonë, e ka edhe zyren për komunitete, që ta ketë edhe Nënkyetarin për komunitete z.Slavisa Jakovljevic.

**Dragan Dancetovic** – lista sérbe në zgjedhjet e kaluara ka treguar seriozitet pér komunitetin sérbe, gjë që edhe sivjet e kemi dëshmuar në 2 mbledhjet e kaluara të këtij mandati. Ne kemi pritë në përgatitjen e kësaj mbledhjeje se do të konsultohemi pér disa çështje pér interesin e komunitetit sérbe, por fatkeqësisht kjo s'ka ndodhë me shpresë se do të bashkëpunonim me të gjithë pér ruajtjen e interesave te pakicës sérbe dhe të gjitha komuniteteve në Komunë. Unë do të votoj kundër propozimit tuaj pér zgjedhjen e Nënkyetarit pér komunitete.

**Shaip Paloja** – unë kérkoj vetëm një sqarim, e para a është e paraparë që kandidati pér Nënkyetar pér komunitete të jetë ai i cili e përfaqëson dhe ka numrin më të madh të votave në Asamble. E dyta, kandidati që e propozoi Kryetari, a ka të drejtë vote, pasi që është i propozuar ai është dashur të jepë këtë çështje.

**Aziz Bici** – unë e dëgjova Kryetarin i cili nuk lidhet as me Statutin, as me ligjin, por tha se ashtu ka qenë dhe ashtu do të vazhdohet pér me pasë ne Nënkyetarin pér komunitete. Edhe njëherë kérkoj sqarim se njëherë se a është brenda Statutit dhe ligjit, apo është vetëm brenda marrëveshjeve që ju si koalicion e keni. Nëse, është e dyta atëherë kérkoj të dijmë se Nënkyetari pér komunitete, cilat të mira ia ka sjellë qytetarëve joshumicë dhe në përgjithë si të gjithë qytetarëve dhe cilat të mira i ka kandidati që e propozoi Kryetari.

**Kryetari** – ne kemi pasë rastin të bashkëpunojmë në 4 vitet e kaluara me z.Jakovljevic dhe janë projekte të shumta nga MPL-ja, që janë sjellë në Komunën tonë nga OJQ-të, si USAID-i, CDF-i, IOM-i dhe bashkëpunime të ndërsjellta që ka pasë me institucionet e nivelit qëndror. Unë e di se çdo vendim që ju e merrni do të procedohet në MAPL, dhe ata do ta jepin interpretimin se a ka qenë ai vendim i ligjshëm apo i kundërligjshëm.

**Aziz Bici** – unë e di se Komuna duhet ta ketë zyrën pér çështje ligjore.

**Hysni Mjeku** – besoj se në këtë pikë të rendit të ditës, po humbim kohë tepër sepse mbi të gjitha është një kategori kushtetuese dhe është e drejtë ekskluzive e Kryetarit të Komunës, që ta propozon kandidatin i cili do të jetë Nënkyetar pér komunitete. Unë besoj se më së miri Kryetari e din se sa ka qenë bashkëpunues në objektivat e interesave të qytetarëve, kështu që besoj se grapi parlamentar i PDK-së, do të jetë pér propozimin e Kryetarit me të vetmin qëllim se me këtë po e përbushim një obligim ligor që rrjedh nga Kushtetuta dhe LVL-ja. Tani, sa kanë qenë votues, e sa nuk kanë qenë këtë e kemi shembull në shumë Komunat tjera, si në Graqanicë e Kllokot dmth edhe komuniteti joshumicë në atë Komunë, që janë shqiptarët përfaqësohen sepse është kategori që nuk mundet me i ikë. Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me 12 vota “Për” 7 vota “Kundër” dhe asnjë votë “Abstenim” morën këtë:

## V E N D I M

**Emërohet z.Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar i Komunës pér Komunitete në Komunën e Obiliqit.**

**VI.Pika e gjashtë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – i kemi 3 kérkesa pér shqyrtim nga Eljesa Terbunja, Daut Mjekiqi dhe Besnik Kastrati dhe meqë KPF-ja, është formuar sot propozoj që këto kérkesa të kalojnë në mbledhjen e ardhshme të KPF-së, të marrim mendimin e Drejtoreve përkatëse dhe të vazhdojmë mëtutje.

**Fatos Kurshumlija** – kérkoj që këto kérkesa të na dërgohen bashkë me material qëne të përgatitemi mirë dhe në mbledhje të Kuvendit ti shqyrtojmë ato kérkesa.

**Burim Gërguri** - pikërisht, kjo është arsyaja që kérkesat të kalojnë së pari në KPF, pastaj në Kuvend, që mos me votue pa ndonjë dokument paraprak.

**Aziz Bici** – çdo kérkesë duhet të dorëzohet në rendin e ditës të seancës paraprake.

**Burim Gërguri** – përgjegjen e njejtë ia dhashë edhe z.Fatos Kurshumlija, se kjo është arsyaja që sot nuk po i trajtojmë ato kérkesa.

**Agim Spahiu** – kërkon nga kuvendarët që të marrin një vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë në Komunën e Obiliqit për disa arsyet e cilat i shpjegoi detalisht.

**Kryetari** – propozoj që në Rregullore të futet edhe një çmim për studentin më të mirë në vit në Komunën tonë dhe ai çmim tē titullohet tashmë me emrin e të ndjerit ish kryesuesit të Kuvendit komunal, Adem Preniqi.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal unanimesh morën 1-ën e shtatorit.

## V E N D I M

VENDIM  
Për dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë në Komunën e Obiliqit

Dhe

Me 20 vota “Për” asnjë votë “Kundër” dhe nië këshilltar nuk mungos sot e sot.

die hje keshii  
**V E N D I M**

**V E N D I M**  
Me propozimin e Kryetarit të Komunës, z.Xhafer Gashi në Rregulloren për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë në Komunën e Obiliqit të përfshihet dhënya e çmimit për studentin më të dalluar të vitit në emër të ish kryesuesit të Kuvendit komunal, tashmë të ndjerit Adem Preniqi.  
Të ndryshme –

**Nazmi Gashi** – unë kam qenë në mandat, por jam tërheqë dhe i vetmi asambleistë në Republikën e Kosovës, që e ka respektue ligjin kam qenë unë, mirëpo nuk pendohem fare sepse kam bërë diçka që është dashur me bë. Të tjerët e kanë vazhdue ashtu si ju ka dhënë mundësia dhe kanë pasë pak durim. Sot rrëth meje diçka u përmendën disa paqartësi, por besoj se jam mik, kolegë dhe shok i mirë për ju, kam ardhë me mandat të qytetarit nga subjekti politik Nisma. Mua, nuk më ka ofrue asnjë parti tjetër përvëç LB-së, për bashkëpunim dhe cila parti që mu kishte ofrue për me qenë konstruktiv kisha pranue. Unë kam një kërkesë pa kushte, bile kur janë në pyetje çlirimtarët, kur është në pyetje z.Aziz Bici, z.Berisha, z.Hysni Mjeku, unë nuk kam kushte sepse këta te unë janë pa kushte. Unë i kam 2 dëshira, që këto 4 vite të jemi konstruktiv, të marrim një mirënjojhe të madhe nga qytetarët se nga Ekzekutivi nuk kërkoj mirënjojhe, por Ekzekutivi ka me qenë i detyruar me marrë mirënjojhe prej neve. Nëse ne gjatë 4 viteve, marrim mirënjojhe prej qytetarëve dhe Ekzekutivi merrë mirënjojhe prej neve, atëherë ne kemi me qenë të suksesshëm.

**Lulzim Sadiku** – kam një kërkesë që të pajisen këshilltarët me kompjuterë dhe pajisje për punë. Mendoj se procedura duhet të filloj tash për telefonat, kompjutera dhe me pajisje për punë të Kuvendit komunal.  
**Dragan Dancetovic** – kërkoi që të dërgojen i një kompjuterë.

**Dragan Dancetovic** – kerkoj që të dërgoni një shkresë në MAPL, në bazë të LVL-së që të shqyrtohet përzgjedhja e Nënkyruetarit të Komunës, për komunitete që kjo përzgjedhje të jetë në përputhje me interesat përfundimtare funksionimin dhe komunikimin në interesat e qytetarëve dhe të Kuvendit komunal.

Aziz Bici – shpresoj se në seancat tjera do të respektohen procedurat. Statuti dhe Bragullorja

Kuvendit. Unë i ftoj edhe njëherë të gjithë këshilltarët e Kuvendit komunal pa dallim se cilit subjekt politik i takojnë, mos të shikojmë se kush është i pari, e kush i dyti, por të shikojmë se çka kërkohet në votim dhe cilat janë prioritetet. Sa i përket asaj se çfarë të kaluare kemi, ne mund të kemi simpati ose përshtypje ndaj njëri tjetrit, por informacion të saktë ende nuk kemi sepse përfat të keq asnjë raport nuk është dhënë për neve, i cili është i verifikuar. Unë jam njëri prej atyre që në të gjitha institucionet qoftë komunale apo qëndrore, që sa më shpejt të verifikohet e kaluara e të gjitha organizimeve politike dhe jopolitike sepse vetëm ashtu kemi me pa veten se ku jemi dhe çka na pret.

**Shaip Paloja** – deshta një sqarim lidhur me diskutimin e z.Nazmi Gashi, se nuk është i vetmi ai që ka dhënë dorëheqje, por ka qenë edhe Nënkryetari i atëhershë m z.Hajriz Bekteshi, i cili jo që ka dashur me dhënë dorëheqje, por ligji e ka obligue me dhënë dorëheqje. Ne si kuvendarë, kur po vijmë në mbledhyë vërtetë nuk po kemi ku me i lënë palltot, kështu që a ka mundësi ne si asambleistë të orientohemi dikund

në një zyre bashkarisht, të vijmë edhe pak më heret pse jo, para se të filloj mbledhja, që të kemi një stabilitet para se të hyjmë në mbledhje.


**Kryetari** – meqë, jemi duke bisedue për kushtet dua ta njoftoj z.Paloji se ne jemi duke u zhvendosë nga Komuna e vjetër, që faktikisht mundësitet atje i kemi pasë edhe më të dobëta. Këtu, kryesisht është sistem i hapur, por për çdo takim që ju doni me pasë dhe që vlerësoni se është hapësirë e tepërt kjo këtu ku i kryeni aktivitetet, ne i kemi edhe 2 zyre, lartë te Kryetari dhe është një zyre në katin e parë që e radhës do të kompletoheni.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:30'**


Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli

**Kryesuesi i Kuvendit komunal**

  
Burim Gërguri





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government Administration**

Për:	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Fatos Qerimi, Drejtë i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

Datë: 31/01/2018  
Nr. 020-146

Inderuar Kryetar,  
Inderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrit të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 1-09 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

I miratuar më datë më datë: 24.01.2018

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.01.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjisacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim Nr. 1-09 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.	Vendimi Nr. 1-09 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-së) me të cilin është përcaktuar përbërja e KPF-së prej 7 anëtarëve është në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore për shkak të "Mos përfaqësimit të barabartë të femrave në këtë trup ndihmues të punës se kuwendit". Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore në nenin 6 pika 7 dhe 8 ka obliguar se: "Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse". Lidhur me këtë qështje jeni njostuar paraprakisht nga MAPL, me shkresën Nr. 013-1515 të datës 18.12.2017.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILICIT-OPŠTINA OBILIĆ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlozna

Nr. IV-77  
Br.Data 02.02.2018  
Datum

OBILIC-OBILIĆ



Republika e Kosovës-Republika Kosovo- Republic of Kosova  
Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Data	
Për	Kryeseshin e KK-së, z.Burim Gërguri
CC	Kryetarin e Komunës, z.Xhafer Gashi
Permes	Drejtoreshës së DEFZH-së, z. Zarife Behluli
Nga	Udhëheqësi i Sekt.të ekonomisë, z.Daut Mjeku
Lënda	Kërkesë për inicimin e procedures për ndryshim – plotësim të Rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba



Nga Ju, kërkojmë që të mirret vendim për inicimin e procedurës për ndryshim – plotësim të Rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba nr.I-150 të dt.26.11.2014, për shkakë të harmonizimit me ligjet në fuqi.

Me respekt !



Dalës-Izazna

